



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280-390-112

SILABUS

Lënda: Gjuhë gjermane I

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	Gjuhë gjermane I
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	obligative
Viti i studimeve:	viti i I-rë, semestri i I-rë
Numri i orëve në javë:	2 + 1
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha/ lokacioni:	L: e shtunë, ora 15.00-16.30, Salla A01
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Asoc. Dr. Milote Sadiku
Detajet kontaktuese:	milote_sa@hotmail.com
Përshkrimi i lëndës	Lënda "Gjuhë Gjermane I" synon të ushtruarit e shkathtësive komunikative dhe sociale të nevojshme për komunikim në një gjuhë: të shkruarit, të lexuarit, të folurit dhe të dëgjuarit; përvetësimin e njohurive për strukturën e gjuhës; sensibilizimin për aspektet ndërkulturore. Vokabulari si dhe strukturat gramatikore të trajtuara në këtë lëndë janë të nivelit fillestar A1. Gjatë ligjëratave do të mësohen pjesë nga gramatika e gjuhës gjermane që janë në shërbim të komunikimit dhe që janë të lidhura ngushtë me temat që do të trajtohen gjatë ligjëratave e ushtrimeve të parapara gjuhësore. Të katër shkathtësitë do të ushtrohen përmes trajtimit të temave ndryshme. Njëkohësisht bëhet pasurimi i fjalorit të studentëve me fjalë e konstrukte fjalishë që përdoren gjatë komunikimit në përputhje me nivelin fillestar të njohurive gjuhësore. Krahas teksteve nga libri bazë do të përdoren edhe tekste autentike që ndërlidhen me gjuhën e profesionit dhe me përditshmërinë, CD-të për ushtrimin e shkathtësisë së të dëgjuarit, etj. Temat nga libri bazë i kësaj lënde "Menschen" janë të zgjedhura nga jeta e përditshme dhe nga situatat e përditshme me të cilat ballafaqohet secili në punë dhe përkohë me interesimet e me njohuri fillestare në gjuhë gjermane. Përmes këtyre temave thellohen njohuritë dhe shkathtësitë ekzistuese në komunikimin e përditshëm. Studentët mësojnë si të reagojnë në situata të ndryshme komunikative me njerëz, për profesionet e tyre, për nevojat themelore jetësore, etj. Për të ushtruar shkathtësinë e të dëgjuarit, gjatë ushtrimeve do të

	përdoren edhe CD-të me tema nga libri bazë nga Kursbuch dhe Arbeitsbuch.
Qëllimet e lëndës:	Në këtë lëndë synohet - zhvillimi i shkathtësive receptive dhe produktive të studentit në nivelin A1 të Kornizës së Përbashkët Evropiane; - t'i mundësohet studentit të bëhet përdorues fleksibil i gjuhës gjermane si për qëllime personale ashtu edhe për ato profesionale; - të ngritë vetëbesimin e studentëve dhe aftësinë e tyre për të komunikuar me folësit burimorë dhe joburimorë të gjermanishtes; - të hartojnë tekste të shkurtëra; - të inkurajohet mësimnxënia e pavarur
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të suksesshëm të kësaj lënde, studenti do të jetë në gjendje që: - të kuptojë, të flasë dhe të shkruajë në gjuhën gjermane në nivelin A1 të Kornizës së Përbashkët Evropiane; - të përdorë gjuhën gjermane si për qëllime personale ashtu edhe për ato profesionale; - të komunikojë me folësit burimorë dhe joburimorë të gjermanishtes në nivelin A1; - të hartojë tekste të shkurtëra.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	22.50
Ushtime teorike/laboratorike	1	15	11.25
Kontaktet me mësimdhënësin/konsulti met	10 min	15	2.5
Kollokfiume,seminare			
Detyra të shtëpisë	2.5	15	37.5
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	4	15	60
Përgaditja përfundimtare për provim	5	2	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	2	2
Projektet,prezentimet ,etj	30 min	1	0.5
Totali			146.25:25 = 5.85 6 ECTS

Metodologjia e mësimdhënies:	Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave dhe ushtrimeve, Përdoren metoda të kombinuara dhe qasje konjitive, komunikative dhe ndërkulturore për ta arritur qëllimin: përmirësimin e shkathtësive receptive dhe produktive gjuhësore. Përmes metodës bashkëbiseduese punohet në mënyrë individuale, në çifte dhe në grupe. Në pjesën teorike të lëndës trajtohen elemente të caktuara të strukturës gramatikore të gjermanishtes që janë në funksion të realizimit të komunikimit. Studentët duhet të marrin pjesë në mënyrë aktive në mësim, të punojnë vazhdimisht gjatë semestrit (detyra të shtëpisë) edhe në mënyrë të pavarur.
Metodat e vlerësimit:	Studentët i nënshtrohen vlerësimit përgjatë gjithë semestrit. Testi gjysmësemestral dhe ai final mbahen me shkrim, ndërsa vlerësimi i shkathtësisë së të folurit bëhet gjatë orëve të ushtrimeve. Në vlerësimin përfundimtar përfshihet edhe pjesëmarrja aktive në orën mësimore dhe detyrat e shtëpisë. - Testi gjysmësemestral 30% - Testi final 50% - Aktiviteti në orë (detyrat) 15% - Pjesëmarrja 5%
Literatura	
Literatura bazë:	- <i>Menschen</i>. Kursbuch. A1.1., Hueber Verlag, Ismaning, 2012. - <i>Menschen</i>. Arbeitsbuch. A1.1., Hueber Verlag, Ismaning, 2012 - <i>Vokabeltaschenbuch</i>. A1.1., Hueber Verlag, Ismaning, 2012
Literatura shtesë:	- <i>Deutsch üben. Wortschatz und Grammatik A1</i> . Hueber Verlag, Ismaning, 2018
Plani i dizajnuar i mëimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Njoftimi i studentëve me përmbajtjen e lëndës dhe literaturën e nevojshme - Sich begrüßen; Sich und andere vorstellen; Buchstabieren
<i>Java e dytë:</i>	Grammatik: Verbkonjugation Singular; W-Fragen;
<i>Java e tretë:</i>	- Beruf und Herkunft angeben und danach fragen; kurzen Text über sich Schreiben; Zahlen 1-100 Grammatik: Verbkonjugation Singular und Plural; Negation mit nicht; Wortbildung <i>-in</i> .
<i>Java e katërt:</i>	- Über die Familie sprechen; Grammatik: Ja/Nein-Fragen, ja-nein-doch;
<i>Java e pestë:</i>	- Über Sprachkenntnisse sprechen; Grammatik: Possessivartikel mein/dein; Verben mit Vokalwechsel
<i>Java e gjashtë:</i>	Beratungsgespräche; Nach Preisen fragen und Preise nennen; Grammatik: definiter Artikel <i>der/die/das</i> ;
<i>Java e shtatë:</i>	- Etwas bewerten

	Grammatik: Personalpronomen <i>er/es/sie</i>
<i>Java e tetë:</i>	Testi gjysmësemestral
<i>Java e nëntë:</i>	- Nach Wörtern fragen und Wörter nennen; um Wiederholung bitten; Etwas beschreiben; sich bedanken; Zahlen 100-1.000000; Adjektive Grammatik: indefiniter Artikel <i>ein/eine/ein</i> ;
<i>Java e dhjetë:</i>	- Etwas beschreiben; sich bedanken; Zahlen 100-1.000000; Adjektive Grammatik: Negativartikel <i>kein/keine/kein</i>
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Farben, Dinge; Telefongespräche führen;
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Grammatik: Singular –Plural; Akkusativ
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Über Hobbys/Fähigkeiten sprechen; um etwas bitten, sich bedanken Grammatik: Modalverb können; Satzklammer
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Tageszeiten, Wochentage, Uhrzeiten; Einladung/Absage schreiben Grammatik: Verbposition im Satz; temporale Präpositionen <i>am, um</i>
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Testi final

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
Studenti është i obliguar të vijoje ligjërata dhe ushtrime. Plagjiatura dhe kopjimi në provime janë të dënueshme sipas statutit dhe rregulloreve të tjera të universitetit. Kodi i mirësjelljes vlen si për studentët ashtu edhe për mësime dhënësit	